



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Zyra e Prokurimit
611-22-5902-5-2-1/C560



KONTRATË PUNE
KUSHTET E PËRGJITHSHME, TË VEÇANTA DHE ANEKSET E NDËRLIDHURA

TITULLI: Renovimi i shkollave objekteve shkollor, nyjeve sanitare dhe ngjyrosja dhe suvatimi– Projekt dy vjeqar

Numri identifikues: 611-22-055-521 Datë 06.07.2022

Nr. i arkivit: 400-38177

NENI 1 PALET NË MARRËVESHJE

1. KOMUNA E DRENASIT - DRENAS, përfaqësuar nga GEZIM HAJDINI, Zyrtar i Prokurimit (më tutje "Punëdhënës")
2. **DELTA - CCD SH.P.K.**, përfaqësuar nga: LULZIM ZARAJ - Drejtor (me tutje "Kontraktues")

NENI 1: LËNDA

Lënda e kontratës duhet të jetë kryerja e puneve nga Kontraktuesi në vijim: **Renovimi i shkollave objekteve shkollor, nyjeve sanitare dhe ngjyrosja dhe suvatimi– Projekt dy vjeqar**

1.2 Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të Veçanta dhe të aneksit teknik [duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar]

1.3 Vendi i pranimit të punëve do të jetë: **Renovimi i shkollave objekteve shkollor, nyjeve sanitare dhe ngjyrosja dhe suvatimi– Projekt dy vjeqar**

NENI 2 KOHA E PËRFUNDIMIT

2.1 Afati kohor për kryerje të punëve do të jetë: Sipas Planit dinamik. Operatori Ekonomik duhet të jetë në gjendje gadishmërie dhe sa herë që kërkohet duhet të angazhohet me inxhinier të natyrave përkatëse në mbikqyrjen e projekteve dhe në hartimin e projekteve dhe paramasave nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së punëve do të jetë: **Renovimi i shkollave objekteve shkollor, nyjeve sanitare dhe ngjyrosja dhe suvatimi– Projekt dy vjeqar**

2.3 Vendi i kryerjes së punëve do të jetë në adresën e treguar në Aneksin 7 të Dosjes së Tenderit.

NENI 3 ÇMIMI

ÇMIMI I KONTRATËS: **186 105,48 €**; [Njëqinde e Tetedhete e Gjashtëmije e Njëqinde e Pese EURO e 48cnt] Euro.

NENI 4 RADHITJA E DOKUMENTEVE TE KONTRATËS SIPAS PRIORITYTIT

Kontrata përbëhet nga dokumentet e mëposhtme, sipas prioritetit:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
- (f) (Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës se vendit)

Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

NENI 5 KOMUNIKIMET

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët [Angleze] [Shqipe] [Serbe]¹ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 "Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhinieringu civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

1.3 "Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

1.4 "Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

1.6 "Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.7 "Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

1.8 "Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

1.9 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

¹ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të njoftojë me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Kontraktuesi nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njuh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjesë të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

OBLIGIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Kontraktuesit, pa pagesë, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Kontraktuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato janë në dispozicion. Pas lëshimit të certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi duhet ti kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Kontraktuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Kontraktuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

Neni 6 Qasja në vend punishte

6.1 Autoriteti kontraktues, në kohën e duhur dhe në përputhje me ecurinë e punimeve, do ti jap qasje dhe akses Kontraktuesit në vend punishte, në përputhje me programin e zbatimit të detyrave të përcaktuara në këto Kushte të përgjithshme.

6.2 Kontraktuesi, gjatë shfrytëzimit, duhet të mirëmbaje çdo objekt të vendosur në dispozicion të tij në gjendje të mirë, dhe duhet, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, ti kthej ato në gjendjen e tyre origjinale pas përfundimit të kontratës.

6.3 Kontraktuesi nuk do të ketë të drejtë të ndonjë pagese për përmirësimet që rezultojnë nga puna e kryer me iniciativën e tij.

Neni 7 Ndhurma lidhur me rregulloret vendore

7.1 Kontraktuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marrjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhëratë apo ligjet anësore të Republikës së Kosovës të cilat mund të ndikojnë te Kontraktuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar Kontraktuesit me shpenzime të Kontraktuesit.

7.2 Në bazë të dispozitave të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën, Autoriteti Kontraktues do të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të lehtësuar prokurimin nga Kontraktuesi për të gjitha vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejen e punës dhe lejet e qëndrimit, për personelin, shërbimet e të cilëve Kontraktuesi dhe Autoriteti kontraktues i konsideron të nevojshme, si dhe lejet e qëndrimit për familjet e tyre.

OBLIGIMET E KONTRAKTUESIT

Neni 8 Obligimet e Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

8.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

8.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

8.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenet 12.

8.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritë nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

8.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

8.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

- a. në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe
 - b. në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.
- 8.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktivitetëve në vend punim.

Neni 9 Personeli

9.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuara në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

Neni 10 Siguria e ekzekutimit

10.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

10.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Pranimit të Përkohshëm.

10.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 11 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

11.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

11.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

- (a) humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;
- (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve;
- (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe
- (d) dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

11.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

11.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

11.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbrësë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontraktuesit.

Neni 12 Programi

12.1 Brenda kohës se specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

12.2 Nëse menaxheri i projektit për me tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

12.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

12.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

Neni 13 Siguria në vend punishte

13.1 Kontraktuesi do të ketë të drejtën të ndalojë qasjen në vend-punishte për çdo person i cili nuk është i përfshirë në zbatimin e kontratës, me përjashtim të personave të autorizuar nga Autoriteti Kontraktues.

13.2 Kontraktuesi do të sigurojë sigurinë në vend-punishte gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit dhe do të jetë përgjegjës për të marrë hapat e nevojshëm, në interes të punonjësve të tij, agjentëve të Autoritetit Kontraktues dhe palëve të treta, për të parandaluar çdo humbje ose aksident i cili mund të rezultojë nga kryerja e punëve.

13.3 Kontraktuesi do të marrë të gjitha hapat e domosdoshme, për përgjegjësinë e tij dhe me shpenzimet e tij, për të siguruar që strukturat dhe instalimet ekzistuese mbrohen, ruhen dhe mirëmbahen. Ai do të jetë përgjegjës për sigurimin, me shpenzimet e tij, ndriçimin, sigurinë, skermën dhe pajisjet e sigurisë të cilat janë të nevojshme për zbatimin e duhur të detyrave ose që me arsye mund të kërkohen nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 14 Ndërhyrja me trafikun

14.1 Kontraktuesi do të sigurojë që punimet dhe instalimet nuk shkaktojnë dëme, ose pengojnë trafikun në, lidhjet e komunikimit të tilla si rrugët, hekurudhat, rruge ujore dhe aeroporte. Ai, në veçanti, do të marrë parasysh kufizimet në peshë kur zgjedh rrugët dhe automjetet.

14.2 Çdo masë të veçantë të cilën Kontraktuesi e konsideron të nevojshme, ose është kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të mbrojtjes apo për të përforcuar pjesët e rrugëve, urave, do të bartet në shpenzime të Kontraktuesit, pa marrë parasysh se ato kryhen nuk ato kryhen nga Kontraktuesi. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin kontraktues për çfarëdo masa të veçanta që ai synon të ndërmarrë para se kryej ato. Riparimet e dëmit të shkaktuara në rrugë, ura nga transporti i materialeve apo pajisjeve do të jetë në shpenzime të Kontraktuesit.

Neni 15 Tatimi

15.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

15.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

15.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

15.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

Neni 16 Kostoja e Riparimeve

16.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

FILLIMI DHE VONESAT

Neni 17 Fillimi i punëve

17.1 Kontraktuesi do të filloj punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

17.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instaloj Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësoj ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

Neni 18 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

18.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 38;

18.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

18.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 18.2 Autoriteti Kontraktues do të lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

Neni 19 Dëmet e likuiduara

19.1 Kontraktuesi do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Kontraktuesit.

19.2 Nëse Autoriteti Kontraktues ka fituar të drejtën e vlerës maksimale në bazë të nenit 19.1 ai mundet, pasi ta njoftojë Kontraktuesin:

- (a) konfiskojë garancinë e realizimit; dhe / ose
- (b) të ndërpresë kontratën; dhe
- (c) të hyjë në një kontratë me një palë të tretë në koston e Kontraktuesit për ofrimin e bilancit të punimeve.

MATERIALET DHE MJESHTËRITË

Neni 20 Regjistri i punës

20.1 Një regjistër i punës do të, përveç kur parashikohet ndryshe nga KVK, mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit, i cili do të mbaje të paktën informacionin e mëposhtëm:

kushtet e motit, ndërprerjet e punës që detyrohen nga moti me shi, orët e punës, numrin dhe llojin e punëtorëve të punësuar në vend-punishte, materialet e furnizuara, pajisjet në përdorim, pajisjet jo në gjendje pune, testet e kryera në vend, mostrat e dërguara, rrethanat e paparashikuara si dhe urdhrat dhëne Kontraktuesit;

deklaratat e hollësishme të të gjitha elementeve sasiore dhe cilësore të punës së bërë dhe furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura, të afta për tu kontrolluar në vend-punishte dhe të rëndësishme në llogaritjen e pagesave që duhet bere Kontraktuesit.

20.2 Shënimet e bëra në regjistrin e punës, si pune ne progres, duhet të nënshkruhen nga Autoriteti Kontraktues dhe të bashkë-nënshkruhen nga Kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij. Nëse Kontraktuesi refuzon, ai do të komunikojë pikëpamjet e tij ndaj Autoritetit Kontraktues në afat prej 15 ditësh pas datës në të cilën janë regjistruar te dhënat apo deklaratat kundërshtuese. Nëse Kontraktuesi dështon që të nënshkruajë ose të paraqesë pikëpamjet e tij brenda periudhës së lejuar, do të konsiderohet se Kontraktuesi pajtohet me shënimet e paraqitura në regjistrë. Kontraktuesi mund të shqyrtojë regjistrin e punës në çdo kohë dhe mund, pa hequr dokumentin, të bëjë ose të marr një kopje të shënimeve të cilat ai i konsideron të nevojshme për informacionin e tij.

20.3 Sipas kërkesës, Kontraktuesi do ta sigurojë Autoritetin Kontraktues me informacionin e duhur për të mbajtur regjistrin e punës në mënyrën e duhur.

Neni 21 Origjina dhe cilësia e punimeve dhe materialeve

21.1 Punët, komponentët dhe materialet do të jenë në përputhje me specifikimet, vizatimet, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkesat tjera në kontratë dhe do të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë gjithë periudhës së realizimit.

21.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare do të jenë objekt i një kërkesë të dërguar nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues. Kërkesa duhet ti referohet numrit të kontratës, numrin e Lotit dhe vendin ku do të zhvillohet pranimi i tillë, sipas rastit. Komponentët dhe materialet e specifikuar në kërkesë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkesat për këtë pranim para se të inkorporohen në pune.

21.3 Edhe nëse janë pranuar teknikisht materialet apo artikujt që do të përfshihen në pune ose në prodhimin e komponentëve, ato mund të refuzohen dhe duhet të zëvendësohen menjëherë nga Kontraktuesi nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime. Kontraktuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në pune vetëm nëse janë riparuar.

Neni 22 Inspektimi dhe testimi

22.1 Autoriteti Kontraktues do të emëroj "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

22.2 Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

22.3 Kontraktuesi do të sigurojë që komponentët dhe materialet të dorëzohen në kohë në vend për ti lejuar autoritetit kontraktues që të vazhdojë me pranimin e komponentëve dhe materialeve. Kontraktuesi konsiderohet se ka vlerësuar plotësisht vështirësitë që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe nuk do ti lejohet që të paraqesë ndonjë arsye për vonesë në përmbushjen e detyrave.

22.4 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë, ose nga vetë ose agjentit e tij, që të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë progresin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimin të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për ofrimin e sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vend-punishte ose në ndonjë vend tjetër, siç mund të specifikohet në kontratë.

22.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet, Autoriteti kontraktues do ta njoftojë Kontraktuesin ose do te miratojë certifikimin e procedurës lidhur me këtë.

22.6 Nëse Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi nuk pajtohen për rezultatet e testit, secili do të japë një deklaratë për pikëpamjet e tij ndaj tjetrit brenda 15 ditëve pas ngritjes së mosmarrëveshjes së tillë. Autoriteti kontraktues ose Kontraktuesi mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, nga një ekspert që zgjidhet me pëlqimin e përbashkët. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë te Kontraktuesi. Rezultatet e ri-testimit do të jenë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e të cilit dëshmohet se është gabim nga ri-testimit.

Neni 23 Paralajmërim i hershëm

23.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vone në kualitetin e punëve.

23.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato ne skica apo ne specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitoj menjëherë dhe do t'i konsideroj pasojat.

23.3 Nëse palët ne kontrate vlerësojnë se ndërrimet substanciale te punëve janë bere te nevojshme për shkak te gabimeve te tilla ose te përjashtimeve te cilat substancialisht ndikojnë ne çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do te korrigojnë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit te Prokurimin Publik.

PAGESAT

Neni 24 Pagesa

24.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

24.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do ti paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

24.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhen nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

24.4 Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

Neni 25 Paramasa dhe Paralogaria

25.1 Paramasa dhe paralogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve qe duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbaj aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

Neni 26 Parapagimi

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmoj se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

Neni 27 Mbajtja e Parasë

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim e tërë të Punëve. Kjo shume ne asnjë rast nuk do te tejkaloj 10% e vlerës totale te kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit te deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

Neni 28 Vërtetimet e pagesës

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a) Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Paralogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Paralogari që është përfunduar; ose
- b) Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëj vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

Neni 29 Llogaritja përfundimtare

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatis deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës së llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumen e cila sipas opinionit të tij duhet ti paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumën përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

Neni 30 Shkaqet për kompensim

30.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET

Neni 31 Parimet e përgjithshme

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektit dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të përcaktuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke

iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrimi;
- d. Paga e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesit do të përfundojë vazhdimësinë e përbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësitë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.

- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PIESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.




[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	Të përgjithshmet
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	1.	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
Gjuha e përdorur	2.	Gjuha e përdorur do të jetë [<u>gjuha e procedurës - shqipe</u>].
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	3.	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve: (sipas ligjeve në fuqi) (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve deri në shumën e kontratës; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën deri në shumën e kontratës; (d) dëmtim personal ose vdekje: (ii) të punëtorëve të Kontraktuesit: sipas ligjeve në fuqi. (ii) të personave të tjerë: sipas ligjeve në fuqi.
Programi	8.1	Menaxherët e Kontraktuesit dhe Autoritetit kontraktues duhet ta hartojnë Planin e Menaxhimit të kontratës konform Nenit 81 të Ligjit Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës. Kryetari i komunës, Autorizohet në bazë të Nenit 81 të Ligjit Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 të caktoj me një vendim, Menaxherin e Projektit zyrtarin me përvojë në profesion dhe mundësisht nga Njësia kërkuese dhe komisionin për pranimit teknik me një Vendim tjetër . Të dy palët obligohen të mbajnë ditarin e punës dhe nga një kopje të dorëzohen në arkivin e dosjes për pagesë.
Programi i azhurnuar dhe pagesat	8.2	Periudha për Programin e azhurnuar sipas planit dinamik. Pagesat kryhen ashtu si raporton Organi mbikqyrës, pagesa e fundit kryhet vetëm pasi të ofrohet Garancioni për eliminim e të metave në shumën prej 10 % të vlerës së ofertës.
Inspektimi dhe testimi	9.1	Inspektimin dhe testimin e materialeve e kryen Menaxheri sa herë që kjo shihet e nevojshme. Shpenzimet për testimet e para i kryhen Punëkryrësi, ndërsa herave tjera (kur Menaxheri nuk është i kënaqur) kryhen nga Autoriteti Kontraktues.
Fillimi i punëve	10.1	Data e fillimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës. Punëkryerësi duhet ta ketë në vendpunishte çdo herë Inxhinierin e prezentuar në dosje të tenderit (FATMIR KRASNIQI) inxh. i Ndertimtaris drejtimi konstruktiv-). Nëse pas urdhërit prej tre ditëve nuk paraqitet Inxhinieri i OE në vend punishte, Komuna ka të drejtën t'i jap urdhresen e fundit për nderprerje të kontratës. Poashtu njëjtë vepron edhe kur nuk i angazhon paisjet me të domosdoshme në vendpunishte. Inxhinieri duhet të nënshkruhet çdo herë në situacionet e hartuara nga OE fitues dhe në fletët e ditarit të punës. Ndërrimi evnetual i inxhinierit të paraqitur në dosje bëhet vetëm me një arsyetim bindës, me Pëlqim të Menaxherit komunal.

Nënkontraktimi	10.2	O E i lejohet nënkontraktimi deri në 10% të vlerës së kontratës, mbi këtë përqindje dhe deri në 40 % të shumës së kontratës vetëm me aprovimin e Menaxherit dhe Organit mbikqyrës të caktuar nga komuna.
Mbarimi i punimeve	10.3	Data e përfundimit të të gjitha Punëve do të jetë: Sipas Planit dinamik dhe Planit të menaxhimit të kontratës të nënshkruar nga të dy palët.
Përmirësimi I defekteve	13.1	Periudha garantuese e defekteve është 1 vite.
Shkaqet për kompensim	17.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë sipas kërkesave dhe paraqitjes së rasteve nga DKA
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25 % për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e Çmimit final të Kontratës. Me propozimin e Menaxherit të Projektit dhe aprovimin e Autorizuesit Operatori Ekonomik futet në penale nëse ka tejkalim të ditëve. Nëse ka tejkalim të ditëve dhe Operatori Ekonomik nuk është fut në penale atëherë Menaxheri duhet të jap një arsyetim për mos futje në penale.
Monitorimi	19.2	Menaxheri i projektit obligohet që monitorimin e kontratës në aspektin Ligjor herë pas here ta kryej konform neneve të kontratës dhe ligjeve në fuqi dhe duhet të bindet se kontrata implementohet ashtu edhe si është hartuar. Në rast të kërkesës për ndërprerje të punimeve apo kontratës, Menaxheri i Projektit duhet ta njoftoj ZP duke ia bashkangjite të gjitha shkresat, komunikimet, dhe të bindet se janë shterre të gjitha mundësitë konform neneve të kushteve të kontratës. Poshtu merrë përsipër së bashku me Avokatin komunal të përballet edhe me pengesat eventuale dhe mbrojtjen e kontratës dhe interesave të Komunës para institucioneve tjera.
Parapagimi	20.1	Shuma e parapagimit (avans) : 0
Mbajtja e Parasë	21.1	Shuma e parave të mbajtura është: 0 %
Siguria e ekzekutimit	22.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10 % e shumës së ofertës, validiteti i sigurimit 31.12.2023
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	27.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është plus 10 % e vlerës së kontratës ose nëse dëmi është i madh deri në vlerën e përgjithshme të kontratës. Poashtu nëse kontrata ndërpritet me fajin e Autoritetit kontraktues atëherë Menaxheri jep urdhër për pagesë për të gjitha punët e kryera dhe të papaguara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	31.2	Mundësisht në mes të dy palëve.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [jykatën kompetente] në pajtim me ligjin në Kosovë.

Mbikëqyrja	33.1	Menaxher apo Mbikqyrës nuk mund të caktohet personi i cili ka marrë pjesë në hartimin e paramasave ose specifikimeve dhe as Ai që ka marrë pjesë në vlerësimin e ofertave. Menaxheri i projektit duhet të veproj konform Udhëzimit A01, përkatësisht Nenit 61.
Punët shtesë	33.2	Do të ecet me procedurë për punë shtesë nëse paraprakisht merret autorizimi nga Mbikqyrësi dhe ZKA-ja.
Pagesat	33.3	Të gjitha pagesat bëhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës për punët e kryera do të caktohet nga Menaxheri i Projektit.
Dorëzimi i dokumentave	33.4	Zyrtari ndërlidhës apo Menaxheri para se ta dërgoj dokumentacionin për pagesë në Thesar duhet të binden se ju kanë ofruar të gjitha dokumentet si: Plani i menaxhimit të kontratës , aktvendimet, procesverbalet, raportet, situacionet për punët e kryera të nënshkruara nga inxhinierët, faturat, atestet për materialet e përdorura, shkresat, fletët e ditarit të punës të nënshkruara nga inxhinierët, arsyetimin për tejkalimin e ditëve kalendrike, sigurimet, etj, në të kundërtën e merrë përgjegjësinë.
Arkimi i dokumentave	33.4	Zyrtari ndërlidhës dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimi, urdhërit për pagesë dhe urdhërblerjes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë. Një kopje e faturës, raportit të pranimi pas përfundimit të projektit duhet të dorëzohen në ZP.
Hyrja në fuqi	33.5	Kontrata hynë në fuqi pas nënshkrimit të palëve ose si ditë zyrtare do te konsiderohet dita kur Menaxheri jep urdher per fillimin e punimeve. Kontrata hartohet në 2 kopje origjinale. Vendimi mbi caktimin e Menaxherit dhe Plani i menaxhimit duhet të hartohet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës por asesi pas fillimit të punimeve.

Kësaj kontrate i bashkangjitet:Oferta financiare e Tenderuesit (Paramasa dhe paralogaria e çmimeve).

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	GEZIM HAJDINI	EMRI:	LULZIM ZARA J
Pozita:	ZPP	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	26.07.2022	Data:	26/07/2022
Vula:		Vula:	

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Renovimi i objekteve shkollore, nyjeve sanitare, ngjyrosja dhe suvatimi - Projekt dy vjeçar

RENOVIMI I NYJEVE SANITARE NË SHKOLLA

SQARIM - Në këtë kapitull parashihet të renovohen tërësisht nyjet sanitare në disa shkolla të komunës së Drenasit, e disa pjesërisht. Një nyje sanitare zakonisht përfshihet 6 deri 8 kabina për tualete dhe hapësira për lavabo.

Poz	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
Demolimi					
1.1	Demolimi i mureve me trashësi rreth 25cm. Demolimi do të behet sipas nevojës për ndërje të reja nyje sanitare të shkollave, për hapjen e derës së re dhe të ngjashme.	m ²	35.0	€ 5.00	€ 174.80
1.2	Demolimi i pllakave qeramike së bashku me shtresën e estrihut nga dyshemet e nyjeve sanitare të shkollave, si dhe dergimi i materialit në deponi përkatëse.	m ²	319.8	€ 1.00	€ 319.75
1.3	Thyerja e betonit në dyshemet e nyjeve sanitare të shkollave, në pjesët ku do të vendosen gypat e ri të kanalizimit. Materiali i thyer duhet të largohet deri në deponinë e caktuar. Në këtë çmim duhet të përfshihet germimi në nyje sanitare për vendosjen e gypave, shpimi i mureve për kalim të gypave dhe çfardo demolimi tjetër i nevojshëm për shtrirjen e rrjetit të kanalizimit dhe ujit në këto nyje sanitare të shkollave.	m ²	120.0	€ 10.00	€ 1,200.00
1.4	Ç'montimi i radiatorëve ekzistues dhe montimi i tyre pas përfundimit të punimeve në nyje sanitare të shkollave.	Copë	25.0	€ 5.00	€ 125.00
Muret					€ -
	Furnizimi me material dhe punimi i mureve me blloka siporeksi me llaq adekuat. Më këto mure do të behen ndarje të reja në nyjet sanitare të shkollave dhe mbyllje të dyerve ekzistuese. Në çmim të përfshihet edhe ankerimi i këtyre mureve me muret ekzistuese.	m ²			€ -
1.5	Mure me trashësi t=20cm	m ²	600.0	€ 0.10	€ 60.00
1.6	Mure me trashësi t=12cm	m ²	450.0	€ 0.10	€ 45.00
Izolimi					€ -
1.7	Furnizimi me gjithë materialin e nevojshëm dhe ripunimi i shtresës rrafshuese me beton të varfer me trashësi rreth 6cm në dyshemet e nyjeve sanitare të shkollave, në pjesën ku është demoluar për punimin e rrjetit të kanalizimit.	m ²	120.0	€ 7.00	€ 840.00
1.8	Furnizimi me gjithë materialin e nevojshëm dhe punimi i shtresës së termozilomit me stiropor N4 T=3cm dhe i shtresës së estrihut me trashësi rreth 5cm në dyshemet e nyjeve sanitare të shkollave. Në çmim përfshihet edhe PVC folia.	m ²	320.0	€ 3.00	€ 959.85
1.9	Furnizimi dhe punimi i hidroizolimit horizontal dhe vertikal me lyerje të ftohtë (bitulit) dhe shtresë të kondorit d= 4mm mbi pllakat e dyshemeve dhe në një lartësi të caktuar të mureve në nyjeve sanitare të shkollave. Ngjilja bëhet me flakë kurse kalimi i shtresave është 10cm.	m ²	530.0	€ 8.00	€ 4,240.00
Pllakat qeramike					€ -
1.10	Furnizimi me gjithë materialin e nevojshëm dhe punimi i pllakave qeramike në muret e nyjeve sanitare të shkollave të ndryshme. Pllakat duhet janë të klasit të parë më prerje laserike me dim. 60x120cm dhe ngjiten me ngjitës të cilësisë së lartë (DASS 3000 ose me cilësi të ngjashme). Në çmim duhet të parashihet edhe punimi i fugave dhe vendosja e lasnjeve kendore nga materiali inox. Ndërsa Fuga rreth dyerve, dritareve dhe qoshet duhet të punohet me selikon sanitar të bardhë. Gjatë punimit të pllakave, për nivelim të mirë duhet të përdoren kaset plastike. Ngjyra dhe disajni i pllakave caktohet nga menaxheri i kontratës dhe duhet të jetë i njëjtë për të gjitha nyjet sanitare në të gjitha shkollat. Në çmim të përfshihet edhe demolimi i pllakave ekzistuese dhe dergimi i materialit në deponi.	m ²	190.0	€ 35.00	€ 6,650.00



I.11	Furnizimi me gjithë materialin e nevojshem dhe punimi i i pllakave qeramike në dyshemet e nyjeve sanitare të shkollave të ndryshme. Pllakat duhet janë të klasit të parë më prerje laserike me dim. 60x120cm dhe të ngjitën me ngjitës të cilësisë së lartë (DASS 3000 ose me cilësi të ngjashme). Në çmim duhet të parashihet edhe punimi i fugave. Gjatë punimit të pllakave për nivelim të mirë të përdorën kasete plastike. Pllakat duhet të kenë ramjen e mjaftushme në drejtim të ujëmbledhësve. Ngjyra dhe disajni i pllakave caktohet nga menaxheri i kontratës dhe duhet të jetë i njëjtë për të gjitha nyjet sanitare në të gjitha shkollat.	m ²	46.0	€ 35.00	€ 1,610.00
Rrjeti i kanalizimit					€ -
I.12	Hapja e kanalit me dimensione të nevojshme për punë për vendosjen e gypit kryesor të kanalizimit nga muri i nyjeve sanitare deri të puseta me e afert në oborr të shkollave. Këtu llogaritet hapja e kanalit për nyjet sanitare të disa shkollave, vendosja e rerës rreth gypit, mbyllimi i kanalit pas vendosjes së gypit dhe largimi i dheut të tepërt.	m'	45.0	€ 3.00	€ 135.00
	Furnizimi dhe instalimi i gypave PVC dhe i pjesëve fazonike për kanalizim fekal, lidhjet me goma dihtung në disa nyje sanitare në disa shkolla. Në çmim duhet të përfshihet edhe testimi i rrjetit nën presion të ujit, si dhe demolimi dhe largimi i rrjetit ekzistues.				
I.13	Gyp PVC Ø50	m'	347.0	€ 1.50	€ 520.50
I.14	Gyp PVC Ø70	m'	143.0	€ 2.00	€ 286.00
I.15	Gyp PVC Ø125	m'	102.0	€ 2.50	€ 255.00
I.16	Degzimi Ø125/100 dhe Ø125/70, kthesa Ø125, Reduktues 125/100 e të ngjashem.	Copë	140.0	€ 5.00	€ 700.00
I.17	Degzim Ø100/70, kthesa Ø100, Reduktues 100/75 e të ngjashem.	Copë	143.0	€ 5.00	€ 715.00
I.18	Degëzim Ø70/70, Ø70/50, Kesa Ø70	Copë	240.0	€ 4.00	€ 960.00
I.19	Degëzim Ø50/50, Kesa Ø50	Copë	222.0	€ 5.00	€ 1,110.00
I.20	Furnizimi dhe montimi i Ujëmbledhësve Ø50mm, me gjërsi 50cm, nga materiali inox.	Copë	430.0	€ 1.00	€ 430.00
I.21	Furnizimi me material dhe montimi i ujëmbledhësit nga materiali inox me gjatësi 50cm në nyje sanitare të shkollave. Në çmim duhet të përfshihet edhe demolimi i reshtkes ekzistuese, demolimi i pllakave qeramike dhe shtresës së estrihut për aq sa është e nevojshme për montimin e reshtkës së re në rrjetin ekzistues. Në çmim të përfshihet vendosja e dy kthesave pvc 45shkallë.	Copë	10.0	€ 25.00	€ 250.00
Rrjeti i ujësjellësit					
I.32	Furnizimi dhe montimi i gypave të ujit nga gjakomini. Sistemi punohet në muret dhe nën dyshemen e disa nyjeve sanitare në disa shkolla. Në çmim të përfshihen edhe elementet e nevojshme për lidhje me gypin furnizues të ujit, si dhe demolimi dhe largimi i rrjetit ekzistues.				
I.33	uji i ftohtë : Ø 16 mm ———	m'	594.0	€ 2.20	€ 1,306.80
I.34	uji i ngrohtë : Ø 16 mm ———	m'	265.0	€ 2.20	€ 583.00
I.35	uji i ftohtë : Ø 25 mm ———	m'	130.0	€ 4.00	€ 520.00
I.36	Furnizimi me gjithë materialin e nevojshëm, montimi dhe fiksimi në muri i kokave përfundimtare të gypit të ujit me të gjitha elementet përciellëse. Kokat duhet të jenë të kualitetit të lartë të tipit TDM ose ekujvalent dhe duhet të jenë prodhim me CE, si dhe të të testohen në rrjedhje nën presion.	Copë	238.0	€ 3.00	€ 714.00
I.37	Furnizimi me material dhe montimi në muri i kasetës ujit për deri në 14 kolektorë në një rend. Në çmim përfshihet edhe demolimi i kasetës së vjetër me elemente.	Copë	170.0	€ 0.10	€ 17.00
I.38	Furnizimi me gjithë materialin e nevojshëm dhe montimi i kolektoreve të ujit. Kolektorët duhet të jenë të kualitetit të lartë (TIEMME ose me cilësi ekujvalente apo më të lartë) dhe duhet të jenë prodhim me CE. Në çmim duhet të parashihen edhe gjysemldhëset. Çmimi llogaritet për një vrimë.	Copë	238.0	€ 6.00	€ 1,428.00

1.39	Furnizimi dhe montimi i fittingjeve në kasten e ujit siç janë: Ventill me holander 1', lidhese, vazhdues, kthesa nipel, mbyllës mesingu 1', reduktues, unazat dhe të gjitha elemente tjera të nevojshme. Çmim duhet të vedoset për një kasetë.	Copë	170.0	€ 0.10	€ 17.00
Elementet sanitare					
1.40	Montimi i Lavamanit më të gjitha elementet përcielëse siç janë: Montimi i guaskës, montimi i baterisë për lavaman (Rubineta), montimi i EK ventilave, montimi me selikon i pasqyrës së thjeshtë drejtpërdrejtë në pllaka qeramike. Në çmim prfshihet vetëm montimi i këtyre elementeve, materialet shpenzuese dhe demolimi i elementeve të vjetra, kurse furizimi me elemente të reja sanitare do të behet nga kontrata për furnizim që ka komuna.	Copë	40.0	€ 120.00	€ 4,800.00
1.41	Montimi i VC guaskës se bashku me fontanë dhe të gjitha elemntet tjera përciellëse përfshirë: EK ventilin dhe gypat fleksibil. Guska duhet të ngjitet mirë më selikon sanitar të bardh. Në çmim prfshihet vetëm montimi i këtyre elementeve, materialet shpenzuese dhe demolimi i elementeve të vjetra, kurse furizimi me elemente të reja sanitare do të behet nga kontrata për furnizim që ka komuna.	Copë	40.0	€ 120.00	€ 4,800.00
1.42	Montimi në muri i Pisures nga porcelani komplet me të gjitha elemntet e nevojshme për funksionalizim (ek-ventillin, gypin, sifonin etj.). Në çmim prfshihet vetëm montimi i këtyre elementeve, materialet shpenzuese dhe demolimi i elementeve të vjetra, kurse furizimi me elemente të reja sanitare do të behet nga kontrata për furnizim që ka komuna.	Copë	17.0	€ 85.00	€ 1,445.00
Elektrika në nyje sanitare					€ -
1.48	Montimi i paneleve për ndriqim me dim. 30x30cm dhe montimi i ndërpreseve (nuk përfshihet furnizimi në këtë pozicion). Në çmim përfshihet edhe demolimi i panele të vjetra.	Copë	70.0	€ 10.00	€ 700.00
1.49	Furnizimi, shtrirja dhe realizimi i lidhjeve të kabllit NYM 3x2.5mm ² . Më këtë kablo do krijohet një prizë e re për tharsen e durëve në ato nyje sanitare ku mungon priza. Në çmim duhet të llogaritet edhe hapja e kanalit të kabllot në muri dhe fiksimi i saj, si dhe Furnizimi, realizimi i lidhjeve dhe vendosja e 10 prizave komplet me kuti modulare Ø60mm.	m'	50.0	€ 2.00	€ 100.00
RENOVIMI I NYJEVE SANITARE NË SHKOLLA					TOTALI € 38,016.70
PUNËT E DYERVE DHE DRITARE					
Dyer PVC për nyje sanitare					
	Furnizimi dhe montimi i dyerve nga PVC me trashësi të profileve min 80mm, me mbyllje me 3 goma (dihtunga), hapësira në mes me panele pvc, profilet pvc të përforcuar me profile metalike me trashësi min 1.5mm dhe të pajisur me mekanizem cilësor për hapje-mbyllje. Dyerit dhe mekanizmi duhet të jenë të prodhuara sipas ISO standardeve. Cilësia e dyerve dhe mekanizmit të jet ekuivalente ose me e lartë me cilësinë e prodhuesit sallamander dhe rreze. Dyerit do të vendosen në nyje sanitare në disa shkolla. Në çmim përfshihet edhe çmontimi i dyerve ekzistuese.				
II.1	Dera PVC 90/200 cm	copë	23.0	€ 315.00	€ 7,245.00
II.2	Dera PVC 90/230 cm	copë	2.0	€ 362.25	€ 724.50
II.3	Dera PVC 80/200 cm	copë	26.0	€ 280.00	€ 7,280.00
II.4	Dera PVC 75/195 cm	copë	10.0	€ 255.94	€ 2,559.38
II.5	Dera PVC 70/200 cm	copë	84.0	€ 245.00	€ 20,580.00
Dyer Alumini në shkollën "Halli Bajraktari" dhe sallën "Rasim Kiqina"					
	Furnizimi dhe montimi i dyerve me profile nga alumini me gjërsi 80mm e trashësi t=1.4mm, me xham tre shtresor dhe mbushje argoni 4+18+4+18+4. Dyer dyhet të jenë të pajisur me mekanizem cilësor për hapje-mbyllje. Në çmim përfshihet edhe çmontimi i dyerve ekzistuese.				
II.6	Dyer dy kraresh dim. 3.8x3.10 (hapja 180x200)	copë	1	€ 2,061.50	€ 2,061.50

II.7	Dyer dy kraresh dim. 4.45x3.40 (hapja 180x200)	copë	1	€ 2,647.75	€ 2,647.75
II.8	Dyer dy kraresh dim. 1.70x3.10 (hapja 170x200)	copë	1	€ 922.25	€ 922.25
II.9	Dyer dy kraresh dim. 1.70x2.10	copë	1	€ 696.15	€ 696.15

Dritare PVC

II.10	Furnizimi dhe montimi i dritareve me profile PVC, me trashësi min 80 mm. Profilet duhet të kenë mbyllje me tri goma, duhet të kanë 7 dhoma termike, duhet të përforcohen më profile metalike me trashësi min 1.5mm. Xhami duhet të ketë tri shtresa xham, dy shtresa gaz argoni dhe folin termo izoluese Lov E. 4(xham) + 16(gaz) + 4(xham) + 16(gaz) + 4(xham+lov E). Dritaret kanë dimensione 2.0x2.0(m ²), e në këtë sipërfaqe ka vetëm një hapje (dritare) me dimensione 1.0x1.0(m ²), e cila duhet të jetë e pajisur me mekanizëm dhe dorëzë të cilësisë së lartë për hapje në dy drejtime. Në çmim përfshihet edhe demolimi i dritarës ekzistuese dhe përmirësimi i shpaletave në rast të dëmtimit.	copë	28	€ 600.00	€ 16,800.00
-------	---	------	----	----------	-------------

PUNËT E DYERVE DHE DRITARE TOTALI € 61,516.53

PUNËT E SUVATIMIT DHE NGJYROSJES NË SHKOLLA

SQARIM: Në këtë kapitull është paraparë të suvatohen dhe ngjyrosen tersisht e pjesërisht disa shkolla. Në disa shkolla lartësia e katit në koridoro dhe në sallën e sportit është e madhe, andaj në çmim duhet të parashihet përdorimi i skeleve.

Poz	Përshkrimi i punës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
Suvatimi					
III.1	Furnizimi me materialin e nevojshëm dhe suvatimi i pllafonit dhe murëve më llaç të gatshëm me trashësi 1-2cm. Në çmim përfshihet edhe gryerja dhe heqja e suvatimit të vjetër.	m ²	513.7	€ 7.00	€ 3,595.73
III.2	Furnizimi me materialin e nevojshëm dhe punimi i mureve të brendshme dhe pllafoneve të shkollës me fasadë 1.5mm (në thas). Paraprakisht nga sipërfaqet e mureve dhe pllafoneve duhet grryhet mirë ngjyra e pastaj këto sipërfaqe të trajtohen me një shtresë bazë PETIEFGRUND (ose ekujvalente) dhe një shtresë rrafshuese lepak i bardh. Në çmim duhet të përfshihen edhe vendosja e këndëve metalike rreth dritarëve dhe në vende tjera ku ka kende. Për shkak të vendosjes së kendeve hapësira e dritareve nuk do të zbritet nga llogaria, ndërsa në vende tjera keni do të llogaritet metër gjatësi.	m ²	6,325.0	€ 3.50	€ 22,137.50
III.3	Furnizimi me materialin e nevojshëm dhe punimi i mureve të brendshme dhe pllafoneve të shkollës me dy shtresa glet. Pas ngurtësimit sipërfaqja e gletit duhet të rrafshohet përmes gryrjes. Paraprakisht nga sipërfaqet e mureve dhe pllafoneve duhet grryhet mirë ngjyra e pastaj këto sipërfaqe të trajtohen me një shtresë bazë PETIEFGRUND (ose ekujvalente) dhe një shtresë rrafshuese lepak i bardh. Në çmim duhet të përfshihen edhe vendosja e këndëve metalike rreth dritarëve dhe në vende tjera ku ka kende. Për shkak të vendosjes së kendeve hapësira e dritareve nuk do të zbritet nga llogaria, ndërsa në vende tjera keni do të llogaritet metër gjatësi.	m ²	610.0	€ 5.00	€ 3,050.00
Ngjyrosja					€ -
III.4	Furnizimi me material dhe lyerja e murëve të brendshme me një shtresë bazë dhe dy shtresa ngjyrë të plastifikuar me bazë selikonr, e cila duhet të jetë plotësisht rezistente ndaj pastrimit me ujë. Murët do të ngjyrosen deri në lartësinë 1.6m nga niveli i dyshemes. VËREJTJE: Paraprakisht duhet të mbuloen me foli dyshemet, inverari, radiatorët dhe gjesendet tjera, në mënyrë që mos të sterpikën me ngjyrë. Elementet e sterpikura duhet të pastrohen para se ngjyra të thahet, në të kundërtën duhet të ndërrohen me të reja. Këto punë do të kryhen në: Sallën e sportit dhe shkollën "Rasim Kiqina", në shkollën e Kishnarekës,	m ²	5,846.0	€ 1.50	€ 8,769.00



III.5	Furnizimi me material dhe lyerja e murëve të brendshme dhe pllafoneve me një një shtresë bazë dhe dy shtresa ngjyrë të bardhë. VËREJTJE: Pararparkisht duhet të mbulohen me foli dyshtemet, inverari dhe gjesendet tjera, në mënyrë që mos të sterpikën me ngjyrë. Elementet e sterpikura duhet të pastrohen para se ngjyra të thahet, në të kundërtën duhet të ndrohen me të reja.	m ²	11,250.0	€	2.00	€	22,500.00
III.6	Ngjyrosja e rrjetave metalike që shërben si mburojë e dritareve në sallën e sportit "Rasim Kiqia" në Drenas.	m ²	55.0	€	5.00	€	275.00
III.7	Furnizimi me material dhe lyerja e murëve të jashtme të shkollës një katëshe (P+0) në Korroticë të Epërme, me një shtresë bazë dhe dy shtresa ngjyrë të plastifikuar me bazë selikon, e cila duhet të jetë plotësisht rezistente ndaj pastrimit me ujë. Në çmim duhet të llogaritet edhe trajtimi dhe përmirësimi më masë adekuate i disa demtimeve të vogëla e të izoluar në sipërfaqën e fasadës.	m ²	530.0	€	5.00	€	2,650.00
PUNËT E SUVATIMIT DHE NGYROSJES NË SHKOLLA						TOTALI	€ 62,977.23

RENOVIMI NË SHKOLLËN "SHABAN POLLUZHA" NË KORROTICË TË EPËRME

PUNËT E KULMIT

PËRSHKRIMI - Objekti shkollorë P+0, me dimensione 41.8x17.3m. Qëllimi kryesor është punimi i izolimit termik me stiropor 10cm mbi pllakën e kulmit të shkollës pasi që nuk ka fare izolim termik. Për të mundur këtë izolim është paraparë që të largohet përkohësisht mbulesa e kulmit nga llamarina dhe largimi i një numër të madhë të elementeve të veku (shtafneve 6x5cm) që janë ankeruar në pllakë e kulmit e kjo e pengon shtrirjen e mirë të izolimit. Shtafnet e veku do të largohen e do të zëvendësohen me traje 8x10cm. Nën shtrirjen e stiroporit do të shtrihen edhe disa kabla të rrymës që përshkruhen në pjesën e elektrikes.

Poz	Përshkrimi i punës	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera		
Çmontimi dhe ri-montimi i mbulesës nga llamarina							
IV.1	Çmontimi i mbulesës së kulmit me panele nga llamarina e valëzuar dhe ri-montimi i tyre pas përfundimit të punimeve. Panelet nga llamarina janë më dimensione afërsisht 1x9m e ato duhet të çmontohen me kujdes, të ruhen me kujdes dhe të shënohen paraprakisht pasi duhet të ri-montohen përseri në të njëjtin pozicion dhe të njëjtat vrime. Në rast të dëmtimit të llamarinës, ajo duhet të zëvendësohet më të re. Bulonat e dëmtuar e ata të ndryshkur duhet të zëvendësohen më të ri. Në këtë çmim përfshihet edhe pastrimi i pllakës së kulmit nga mbeturinat e ndryshme të krijuar nga shpezet dhe të tjera. Çmimi vendoset për sipërfaqe të pllakës së kulmit.	m ²	724.9	€	4.00	€	2,899.48
Riparimi i konstruksionit nga druri							
IV.2	Furnizimi me gjithë materialin e nevojshëm dhe zëvendësimi i elementeve të dëmtuara të konstruksionit të kulmit më traje dhe shtafne të reja të cilat kanë dimensione të ndryshme. Këtu përfshihet edhe largimi i disa shtafneve që janë pjesë e veku e që e pengojnë shtrirjen e izolimit në pllakën e kulmit dhe zëvendësimi i tyre më traje. Çmimi do të llogaritet për m ³ të trajeve të vendosura.	m ³	4.0	€	350.00	€	1,400.00
Izolimi i kulmit dhe estrihu							
IV.3	Furnizimi me gjithë materialin e nevojshëm dhe punimi i izolimit termik mbi pllakën e kulmit të shkollës me këto shtresa: një shtresë foli, dy shtresa stiropor N3, t=2x5cm=10cm, një shtresë tjetër foli dhe shtresa e fundit estrihu t=3cm. Shtresa e stiroporit duhet të vendoset kujdesshem dhe të përputhet mirë rreth trajeve dhe elementeve tjera të konstruksionit të kulmit që janë të ankeruar në pllakë, në mënyrë që të behet izolim sa më i mirë. Në përmetër të pllakës stiropori duhet të vazhdohet përtej pllakës rreth 10cm mbi stiroporin e fasadës dhe të lidhet me shkum kontakti i stiroporit të kulmit me stiroporin e fasadës(murit), në mënyrë që të eliminohen urat termike e pastaj të suvalohet me ngjitës dhe rrjetë kjo pjesë.	m ²	736.8	€	13.00	€	9,577.75
Riparimi i ullukut vertikal dhe streha me llamarinë							
IV.4	Furnizimi me gjithë materialin e nevojshëm dhe mbeshja e strehes me llamarinë të plastifikuar në formë "L" me dimensione afërsisht 60x30cm dhe gjësi të shtrirjes 90cm. Në çmim të përfshihet edhe demolimi i llaperive ekzistuese nga streha.	m ²	84.0	€	11.00	€	924.00

IV.5	Furnizimi me material dhe montimi ollukut vertikal nga llamarinë e plastifikuar me ngjyrë kafe, me diametër $d=120\text{mm}$, me trashësi $t=0.55\text{mm}$. Këta ulluq do t'i zëvendësojnë ulluqet e demtuar nga nxënset (8copë), të cilët janë demtuar deri në lartësinë 2m nga niveli i terrenit. Në çmim të përfshihen edhe 3 brryla, si dhe prerja dhe heqja e ulluqeve ekzistuese.	m'	16.0	€	11.00	€	176.00
PUNËT E ELEKTRIKËS							
<p><i>PËRSHKRIMI - Objekti shkollorë P+0, me dimensione 41.8x17.3m, ka 6 klasë, 2 kabinele, 1 sallë të arsimitareve, 1 zyrë dhe njëzet sanitare. Problemi kryesor është se në shumicën e prizave nuk ka rrymë, numëri i prizave nëpër klasa është i vogël dhe shpërndarja e tyre nuk është në vendet e duhura, për këtë arsye është paraparë që të përforcohet furnizimi për secilën klasë me një kabull 3x2.5 nga siguresat përmes kulmit dhe të bëhet shpërndarje e duhur e prizave nëpër klasë. Kabllit shtrihet nëpër muri pasi që muret do të suvatohen në lartësi. Pastaj, do të bëhet ndërtimi i siguresave, ndërprerësve, prizave dhe trupave ndriçues. Operatori në fund do të bëjë testimin e rrjetit e kjo duhet të përfshihet në çmimin e elementeve të vendosura me poshtë.</i></p>							
Instalimi i kabllave							
IV.6	Furnizimi, shtrirja dhe realizimi i lidhjeve të kabllit NYM 3x2.5mm ² . Me këtë kablo do të furnizohen nga kutia e siguresave 10 klasë me nga një lidhje. Kabllot do të shtrihen mbi pllakën e kulmit mbi të cilën do të punohet estrihu. Në çmim duhet të llogaritet hapja e kanalit në muri për vendosjen e kabllit (pa gyp) nga pllaka deri të prizat dhe të siguresat, shpimi i pllakës 11 vende, si dhe gypi i brinjëzuar për vendosjen e kabllit që shtrihet mbi pllakë.	m'	215.0	€	2.00	€	430.00
IV.7	Furnizimi, shtrirja dhe realizimi i lidhjeve të kabllit NYM 3x2.5mm ² . Me këtë kablo do të rritet numëri i prizave dhe do të bëhet shpërndarja e prizave të reja në pjesën ku mungojnë ose janë në defekt. Shtrirja e kabllit bëhet nga furnizimi që ndodhet brenda se cilës klasë e deri të prizat. Në çmim duhet të llogaritet edhe hapja e kanalit të kabllit në muri dhe fiksimi i saj.	m'	140.0	€	2.00	€	280.00
IV.8	Furnizimi, shtrirja dhe realizimi i lidhjeve të kabllit NYM 3x1.5mm ² . Me këtë kablo do të zëvendësohen kabllot e ndriçimit që janë në defekt. Shtrirja e kabllit bëhet nga pika e furnizimit që ndodhet brenda se cilës klasë e deri të ndriçimi. Në çmim duhet të llogaritet edhe hapja e kanalit të kabllit në muri e në pllakë, si dhe fiksimi i saj.	m'	60.0	€	1.50	€	90.00
Instalimi i prizave, ndërprerësve, siguresave dhe trupave ndriçues							
IV.9	Furnizimi, realizimi i lidhjeve dhe vendosja e prizave modulare njëfazore 250V, 16A komplet me kuti modulare Ø60mm. Në çmim duhet të përfshihet hapja e vrimes dhe fiksimi i kutisë Ø60mm në muri.	copë	350.0	€	0.10	€	35.00
IV.10	Furnizimi, realizimi i lidhjeve dhe vendosja e ndërprerësve, 10A.	copë	18.0	€	6.00	€	108.00
IV.11	Furnizimi, realizimi i lidhjeve dhe vendosja e siguresave automatike modulare me karakteristike veprimi B, me aftësi ç'kyçëse 6kA dhe rrymë nominale $I_n=16-20\text{A}$. Në çmim duhet të përfshihet të gjitha elementet për funksionalizim të tyre dhe demolimi i siguresave të vjetra. Siguresat duhet të kenë në etiketë shënjestën CE.	copë	50.0	€	6.00	€	300.00
IV.12	Furnizimi, realizimi i lidhjeve dhe vendosja e Trupave ndriçues me dimensione 60x30cm, me kapacitet të ndriçimit 30Vat, si dhe demolimi i trupave ndriçues të vjetër.	copë	75.0	€	35.00	€	2,625.00
RENOVIMI NË SHKOLLËN "SHABAN POLLUZZHA" NË KORROTICË TË EPËRME						TOTALI	€ 18,845.23
PUNËT TË NDRYSHME							
Linoleumi në shkollën e Negrocit							
V.1	Furnizimi dhe vendosja e dyshemesë nga Linoleumi me trashësi min. 2.0mm, përfshirë këtu edhe shtresën për vet-nivelizim, shtresën e ngjitesit dhe lasnjat ansore. Linoleumi do të ngjitet në koridoret e shkollës në Negroc mbi sipërfaqën me pllaka qeramike. Ngjyra dhe dizajni duhet të jetë i ngjashme me Linoleiumin e klasëve.	copë	860.0	€	0.05	€	43.00
SHKALLET (në shkollën e Kishinarrës)							



V.2	Furnizimi me material dhe veshja e shkallëve të brendshme të shkollës në Kishnarekë me granit natyror me trashësi min 2cm. Krahu i shkallëve ka gjërsi 2.30m', shkelësja 30cm dhe ballorja 17cm. Në çmim duhet të parashihet edhe demolimi i pllakave qeramike nga shkallet, si dhe formimi i bazës së përshatshme për vendosjen e granitit dhe në fund poliri granitit. Të gjitha punët dhe veshja e shkallëve duhet të behet sipas praktikave më të mira në Kosovë	copë	16.0	€ 90.00	€ 1,440.00
V.3	Furnizimi me material dhe punimi i gardhit (giliderave) të shkallëve të brendshme në shkollën e Kishnarekës me profile metalike. Gardhi duhet të punohet më dy rinde horizontale profile metalike 40x40x2mm, shtyllat 40x40x2mm më lartësi h=1.0m, vendosen çdo 1.5m dhe ankerohen mirë në beton, mbushja me profile vertikale 30x10x1.5mm, me lartësi h=0.82m, vendosen çdo 10cm. Dorza e sipërme horizontale për gjalë shkallëve ø50x1.8mm. Profilet metalike salldohen në mënyrë profesionale dhe ngjyrosën me një shtresë bazë dhe dy shtresa ngjyrë të zezë. Në çmim përfshihet edhe demolimi i shkallëve ekzistuese.	m'	13.3	€ 90.00	€ 1,197.00

PLLAKA AMSTRONG (në shkollën e Dobroshecit)

€ -

V.4	Furnizimi me material dhe montimi i pllakave të gipsit të plastifikuar me lëshim, me trashësi t=8mm (Armstrong) dhe dimensione 60x60cm në pflafonet e klasëve në shkollën e Dobroshecit. Pllakat duhet të jenë e klasit (A) dhe të jenë rezistente ndaj lagshmësisë dhe mykut. Në çmim duhet të llogaritet konstruksioni me profile metalike dhe ankerat për pflafonin e lëshuar.	m ²	125.0	€ 14.00	€ 1,750.00
-----	---	----------------	-------	---------	------------

KLIMA NË SHKOLLËN TEKNIKE

V.5	Furnizimi dhe montimi i Klimave/Inventor për ftohje dhe ngrohje - 20/+40, 12000BTU, Efiçenca A+++/A+++ . Kondicioneri duhet jet prodhim me CE, të këtë të pakten 4 vite garancion nga prodhuesi. Në çmim duhet të përfshihet edhe pjesa e jashtme edhe mbajtësi.	copë	20	€ 15.99	€ 319.80
-----	--	------	----	---------	----------

TOTALI € 4,749.80

REKAPITULLIMI I TË GJITHA PUNËVE

RENOVIMI I NYJEVE SANITARE NË SHKOLLA	€ 38,016.70
PUNËT E DYERVE DHE DRITARE	€ 61,516.53
PUNËT E SUVATIMIT DHE NGYROSJES NË SHKOLLA	€ 62,977.23
RENOVIMI NË SHKOLLËN "SHABAN POLLUZHA" NË KORROTICË TË EPËRME	€ 18,845.23
PUNËT TË NDRYSHME	€ 4,749.80
TOTALI I KONTRATËS	€ 186,105.48

Plan i dinamik përfshin 80 dite PUNE (40 ditë pune për vitin 2022 dhe 40 ditë pune për vitin 2023)

Vërejtje: Gjatë vitit 2022 do të realizohen punime në vlerë 80,000€, pjesa tjetër do të realizohet gjatë vitit 2023. Të gjitha materialet e përdorura duhet të jenë të klasit të parë, mostrat paraprakisht duhet të aprovohen nga menaxheri i kontratës. Punimet duhet të kryehen sipas praktikave më të mira të aplikuar në Kosovë. Në çmim duhet të përfshihet tvsh dhe të gjitha taksat. Në rast nëvoja, Menaxheri i Kontratës mund të kërkoj rritjen apo zvoglimin e sasisë së një apo më shumë pozicioneve deri në ±30% të vlerës së përcaktuar dhe operatori është i obliguar të veprojë sipas kësaj kërkesë. Është obligativ të bashkangjitet dosjes një kopje o ofertës (Paramasës) në PDF o vulosur dhe nënshkruar.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)

Emri i OE: "DELTA-CCD" SH.P.K.
 Emri dhe mbiemri i përfaqsesit të O.E Lulzim Zaraj
 Nënshkrimi:
 Data: 06.07.2022
 vula:

